



PER NJE SHOQERI CIVILE ME TE ZHVILLUAR

Në këtë numër:

Zgjedhjet vendore 2007 dhe Partnerët-Shqipëri, programi i granteve

faqe 1-3

Programi i Trainimit, seri trainimesh në "Qeverisje me Pjesëmarrje"

faqe 3

"Përmirësimi i Qëndrueshmërisë së OJF-ve", program i mbështetur nga Qendra ndërkombëtare Olof Palme, Programi i Trainimeve dhe Asistencës Teknike me PSHM dhe trainime të tjera

faqe 4

Programi i Sfidës së Mijëvjecarit për Shqipërinë

faqe 5

Kodi i Etikës për OJF-të

faqe 5-6

Aktivitetet e ardhshme

faqe 6

Partnerët-Shqipëri ka publikuar edicionin e tretë të Adresarit të OJF-ve Shqiptare 2007, në shqip dhe anglisht. Ky Adresar përmban informacion të rifreskuar mbi sektorin e OJF-ve në Shqipëri.

Mund të kontaktoni në çdo kohë me zyrën e Partnerëve-Shqipëri për të blerë kopje të Adresarit. Ndërkohë, versioni elektronik i Adresarit mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Partnerëve-Shqipëri.



Zgjedhjet vendore 2007 dhe Partnerët-Shqipëri

Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore të Përsëritura, 6 Maj 2007

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë i përbërë nga tetë organizata me eksperiencë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve, monitoroi zgjedhjet vendore të 18 Shkurtit 2007, në 2301 qendra votimi. Mbështetur teknikisht dhe financiarisht nga Partnerët-Shqipëri dhe NDI nën kuadrin e programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri, ky

e përpjekjes monitoruese të Zgjedhjeve të Përsërituara.

Monitorimi në katër njësi administrative përfshirë Mini Bashkia No.10, bashkia e Bushatit, komuna Qendër Vlorë në Qarkun e Vlorës dhe komuna Libofshë, u zbatua sipas principit një qendër votimi – një vëzhgues. Koalicioni rekrutoi rreth 100 vëzhgues për të monitoruar procesin e votimit, numërimit dhe



Konferencë për shtyp e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë

koalicion ka qenë sërish prezent në zgjedhjet e përsëritura në 6 Maj 2007. Koalicioni e vlerëson si shumë të rëndësishme prezencën e tij në zhvillimin e procesit zgjedhor.

Ky Koalicion ishte i vetmi bashkim vullnetar i pavarur i cili monitoroi procesin e votimit, numërimit të votave dhe njofftimin e rezultateve nga KZV në 20 njësi administrative ku u përsëritën zgjedhjet. Nëpërmjet punës së tij, Koalicioni:

- Informoi qytetarët shqiptarë rreth transparencës së procesit;
- Ofroi një raport alternativ nga shoqëria civile e cila monitoron në bazë të principeve të pavarësisë politike, objektivitetit, përgjegjësisë dhe transparencës dhe respektit për principet demokratike.

Aktiviteti monitorues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë gjatë ditës së zgjedhjeve u pasqyrua gjerësisht në median e shkruar dhe vizive.

Strategjia e Koalicionit gjatë ditës së Zgjedhjeve dhe rezultatet

anuncimin e rezultateve ndërkohë që në gjashtëmbëdhjetë njësitë e tjera përfshirë: Shosh, Shalë, Pult, Lurë, Iballë, Arrën, Milot, Gjerbës, Kodovjat, Voskop, Kelmend, Hekal, Koms, Shupenzë, Qendër Clirim dhe Qendër Malësi e Madhe koalicioni rekrutoi një skuadër të lëvizshme.

Vëzhguesit raportuan gjatë gjithë ditës në Qendrën Operative që koalicioni ngriti në mjediset e programit DQSH. Bazuar në informacionin e mbledhur Koalicioni dha dy konferenca për shtyp për të informuar publikun rreth progresit të procesit të votimit gjatë ditës së Zgjedhjeve.

Nëpërmjet tyre Koalicioni deklaroi që:

- Interesi i elektoratit për këtë proces zgjedhor të përsëritur ishte i ulët. Vecanërisht i theksuar ishte ky fenomen në njësitë zgjedhore në Tiranë, Qendër Vlorë dhe Bushat. Pjesëmarrje më e lartë u shënuan në Kelmend rreth 70%, Kodovjat

rreth 60%, Gjersës rreth 75%, Arren rreth 85%;

- Megjithëse ngarkesa politike që shoqëroi procesin, në krahasim me zgjedhjet e zhvilluara me 18 shkurt 2007, ishte më pak e ndieshme, në raste të vecanta u vrojtuan ndërhyrje dhe /ose tentativa për ndërhyrje abuzive në procesin zgjedhor, psh në Tiranë Njësia Bashkiake nr. 10, në qendrat e votimit në shkollën Qemal Stafa, Dora d'Istria, në njësitë zgjedhore Qendër Vlorë, Shllak, Bushat etj;

- Forcat politike që kishin kandidatë në këtë proces zgjedhor, nuk e plotësuan në kohë detyrimin ligjor për propozimin e anëtarëve të komisioneve të nivelit të dytë dhe sidomos të komisioneve të qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit;

- Procedurat gjatë ditës së votimit, në përgjithësi, u zhvilluan normalisht, në një klimë të qetë dhe pa probleme. Gjatë procesit të votimit u vëzhguan raste të pakta në numër, (i) të përdorimit abuziv të certifikatës si dokument identifikimi, (ii) pasaktësi në listën e votueseve, (iii) votimi në grup dhe votim familjar, (iv) shoqërim i votuesit me më shumë se një person në dhomën e fshehtë.

Mbyllja e procesit të votimit, administrimi i materialeve zgjedhore dhe transporti i tyre në vendet e numërimit të votave u kryen normalisht. U vu re që:

- Procedurat e numërimit të votave në përgjithësi u realizuan në përputhje me ligjin dhe nuk u vëzhguan zvarritje të qëllimshme;

- Administrimi i procesit zgjedhor prej komisioneve të qendrave të votimit në disa raste u kompromentua prej sjelljeve politike të anëtarëve të tyre dhe/ose nivelit të pamjaftueshëm të njohurive të tyre;

- Forcat e policisë në të gjitha rastet u sollën në përputhje dhe respektim të ligjit;

- Media elektronike, megjithëse interesi politik për këto zgjedhje nuk ishte i madh, u angazhua dhe e pasqyroi në kohë dhe me cilësi këtë proces zgjedhor.

Lancimi i Raportit Final të Monitorimit të Zgjedhjeve Vendorë

Pas deklaratës së gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake më 19 Shkurt 2007, Koalicioni i Vëzhguesve



Tryezë e Rrumbullakët për Prezantimin e Raportit Final të Monitorimit të Zgjedhjeve Vendorë

Vendorë vazhdoi aktivitetin e tij monitorues me fokus zhvillimin e procesit për fazat e mbetura përfshirë: numërimin e votave dhe shpalljes së rezultateve, ndjekjen e ankesave dhe monitorimin e zgjedhjeve lokale në zonat zgjedhore ku ato u përsëritën. Koalicioni i Vëzhguesve Vendor, si një bashkim vullnetar, në funksion të vëzhgimit dhe vlerësimit të procesit zgjedhor, ka si objektiv të tij zhvillimet e mëtejshme organizative e institucionale, të cilat krijojnë kushte me të mira për zbatimin, në terrenin shqiptar, të parimeve dhe standarteve bazë në vëzhgimin e proceseve zgjedhore prej vëzhguesve vendor.

Qëllimi final i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë është që nëpërmjet monitorimit dhe vëzhgimit të proceseve zgjedhore, të japë ndihmesën e tij për zhvillimin e këtyre proceseve në Shqipëri, në përputhje dhe përmbushje të parimeve bazë të trashëgimisë elektorale europiane: Zgjedhje demokratike, të lira, të ndershme, të barabarta dhe të fshehta.

Bazuar në monitorimin e aktivitetit dhe informacionin e mbledhur vëzhguesit lokalë të koalicionit përgatitën një raport përfundimtar gjithëpërfshirës për të gjithë procesin zgjedhor duke përfshirë rekomandimet për përmirësim në të ardhmen, të cilat u paraqitën dhe në tryezën e rrumbullakët të organizuar më 15 Maj 2007, në Hotel Rogner.

Koalicioni njohu përmirësimet e bëra në Kodin Elektorale, por megjithatë ai bën thirrje për rishikime dhe rekomandime të mëtejshme.

Gjatë këtij aktiviteti koalicioni lançoi rezultatet dhe zonat më problematike gjatë procesit të

monitorimit si dhe rekomandimet për përmirësimin e Kodit Elektorale. Përfaqësues të sektorëve të rëndësishëm si: përfaqësues të partive politike, kryetari i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, përfaqësues të sektorit të shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare ishin pjesë e kësaj tryeze së rrumbullakët. Ky aktivitet u pasqyrua edhe në media.

Përpjekja për monitorim gjatë gjithë këtij procesi u mbështet nga kryetari i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Z. Çlirim Gjata i cili gjatë zhvillimit të tryezës së rrumbullakët u shpreh: "I rekomandoj partive politike që të marrin në konsideratë propozimet dhe rekomandimet e Koalicionit në procesin e reformës zgjedhore". Gjithashtu vlen të përmendet që përfaqësues të partive politike vlerësuan rolin e Koalicionit në vëzhgimin e zgjedhjeve " ..vlerësojmë raportin, gjetjet dhe rekomandimet e bëra për procesin zgjedhor "...- Aleksandër Biberaj, Partia Demokratike.

Raporti përfundimtar i Koalicionit mund të gjendet në versionin shqip dhe anglisht në faqen e internetit të Partnerëve-Shqipëri www.partnersalbania.org.

Monitorimi i Shpenzimeve Publike për Shërbimin e Veterinarisë Publike - Zhvillimi i Komunitetit të Fermerëve në Luftë Kundër Korrupsionit

Me mbështetjen e Partnerëve Shqipëri/DQSH organizata Blekalb - Shkence Teknologji Shërbim Këshillimor për Zhvillimin e Fermës zbatoi një projekt i cili kishte si qëllim krijimin dhe zhvillimin e përvojave në punën me komunitetet në zonat rurale, për aktivizimin dhe përfshirjen e tyre në luftën kundër shfaqjeve të fenomeneve korruptive në përdorimin e fondeve publike. Projekti synoi zhvillimin

e kapaciteteve të nevojshme të përfaqësuesve të komuniteteve të cilët do të mundësojnë realizimin e presionit qytetar për më shumë transparencë dhe efektivitet në përdorimin e fondeve publike.

Për të diskutuar rezultatet e arritura dhe rrugët që duhet të ndiqen me qëllim rritjen e efektivitetit në Shërbimin Publik Veterinar, u zhvillua në Vlorë Seminari Kombëtar "Shërbimi veterinar publik, efektiviteti i fondeve, transparenca, informimi i publikut, niveli i shërbimit"

Në këtë aktivitet morën pjesë: Drejtori dhe specialistët të Drejtorisë së Shërbimit Veterinar në Ministrinë Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, drejtuesit rajonalë të Shërbimit Veterinar Publik nga 12 qarqet e vendit, anëtare të grupeve të reagimit qytetar kundër korrupsionit nga zona rurale të qarqut Vlorë dhe Fier, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë

në qarkun e Vlorës etj.

Në seminar u paraqitën rezultatet kryesore në lidhje me perceptimin e komunitetit të fermerëve për efektivitetin në përdorimin e fondeve që buxheti i shtetit i jep në mënyrë të përvitshme Shërbimit Veterinar Publik, vlerësimin për transparencën në përdorimin e këtyre fondeve. U theksua se një ndër faktorët kryesore që kufizon në mënyrë të ndieshme efektivitetin e këtyre fondeve është planifikimi dhe disbursimi i fondeve, që janë të pamjaftueshme dhe jo në përgjigje të nevojave reale që ka Shërbimi Veterinar Publik.

Përfundimet e paraqitura në këtë Seminar ishin rezultat i punës së grupeve qytetare të reagimit kundër korrupsionit, që veprojnë në disa komuna të rretheve Sarandë, Gjirokastrë, Tepelenë, Vlorë, Elbasan, Lezhë e Shkodër.

Programi i Trainimeve dhe Asistencës Teknike

Unë Mbështes Qeverisjen e Mirë

Gjatë muajve në vazhdim, Partnerët-Shqipëri do të zbatojnë fazën e katërt të iniciativës "Unë Mbështes Qeverisjen e Mirë" duke asistuar grupet e interesit që të monitorojnë dhe advokojnë pranë pushtetit vendor për mbajtjen e premtimeve të bëra prej kandidatëve gjatë fushatës të zgjedhjeve për Pushtetin Vendor të 18 Shkurt 2007. Qytetet e përfshira në këtë iniciativë janë Shkodër, Durrës, Gjirokastrë, Vlorë, Pogradec, Korçë, Fier dhe Elbasan.

Partnerët-Shqipëri ka hartuar një program trainimesh dhe asistencë teknike për të rritur kapacitetet dhe përpjekjet advokuese të grupeve të interesit në këto qytete; për të rritur bashkëpunimin midis pushtetit vendor dhe këtyre grupeve për të adresuar prioritetet e komunitetit dhe për të implementuar një teknikë pjesëmarrëse për monitorimin e punës së qeverisjes vendore qytetet respektive.

Në këtë kuadër, ka filluar zbatimi i një serie programesh trainimi të avancuara në "Qeverisje me Pjesëmarrje"; në "Teknikat e Pjesëmarrjes Qytetare - Karta Raportuese e Qytetarëve, Komisionet Këshillimore Qytetare, Buxhetimi me Pjesëmarrje" dhe tre programe trainimi në "Aftësitë Lehtësuese" me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe grupeve të interesit në tetë qytetet e sipërpërmendura.

Më pas, P-Sh do të ofrojë asistencë teknike për këto grupe me qëllim organizimin e fushatave të suksesshme të advokacisë për çështjen e tyre duke implementuar aftësitë dhe njohuritë e mësuara gjatë programeve të trainimit. Qëllimi i fushatave të advokacisë do të jetë monitorimi dhe influencimi i pushtetit vendor në funksion të prioritetëve të qytetarëve duke zbatuar një nga teknikat e pjesëmarrjes qytetare.

Programi i Trainimit "Qeverisje me Pjesëmarrje"

Fokusi i programeve të trainimit të ofruara nga P-Sh gjatë këtyre muajve ka qenë rritja e rolit aktiv dhe përfshirja në proceset vendim-marrëse e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit që organizatat lokale përfaqësojnë. Një seri programesh trainimi janë ofruar në këtë periudhë duke synuar zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të përfaqësuesve të OJF-ve lokale dhe pushtetit vendor mbi rëndësinë e një qeverisjeje me pjesëmarrje si dhe aplikimin e teknikave që mundësojnë përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrje e që krijojnë ura bashkëpunimi mes pushtetit vendor dhe shoqërisë civile.

Gjatë periudhës Mars - Maj 2007, Partnerët - Shqipëri ofroi programe trainimi me temë "Qeverisja me Pjesëmarrje" në



Programi i Trainimit në Krujë

lokale dhe të pushtetit vendor ishin: njohja me konceptin e pjesëmarrjes në qeverisje; rëndësia e pjesëmarrjes dhe planifikimit me pjesëmarrje; kush përfiton nga pjesëmarrja e qytetarëve në qeverisje; aspekte / elementë të qeverisjes së mirë; nivelet e pjesëmarrjes; faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje; teknika të qeverisjes me pjesëmarrje që sjellin më afër qytetarët në procese vendim-marrëse dhe i përfshijn ata më shumë në të gjitha nivelet etj.

Të pranishmit në këto programe trainimi e vlerësuan si shumë pozitiv faktin e organizimit të programeve të tilla që rrisin nivelin e informacionit dhe i aftësojnë të dyja palët si përfaqësuesit e organizatave lokale dhe ata të pushtetit vendor të bashkëveprojnë më mirë dhe t'u krijojnë hapësirat e duhura njëri-tjetrit. Gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve u vunë re përpjekje në nivele të ndryshme për përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrjen lokale.

Kështu në qytetin e Elbasanit ka patur një përpjekje nga ana e pushtetit vendor në bashkëpunim me OJF-të lokale për hartimin e një strategjie rajonale me pjesëmarrjen e



Programi i Trainimit në Elbasan

Tiranë, Krujë, Elbasan, Fier dhe Durrës. Rreth 90 përfaqësues të OJF-ve nga Tirana, Durrësi, Peshkopia, Elbasani, Librazhdi dhe Kruja ishin përfitues të këtyre programeve trainimi.

Disa nga çështjet kryesore të trajtura gjatë këtij programi trainimi me përfaqësuesit e organizatave jo fitimprurëse

publikut dhe përfshirjen e opinioneve nga grupe të ndryshme interesi; në qytetin e Krujës ka filluar një organizim i mirë i punës brenda pushtetit vendor dhe vërehet një disponibilitet i lartë për përfshirjen e qytetarëve në procese vendim-marrëse; ndërkaq në qytetin e Fierit ka patur shembuj të mirë të aplikimit të kartës raportuese të qytetarit si dhe të procesit të

buxhetimit me pjesëmarrje.

Gjatë programeve të trainimit, të pranishmit u angazhuan jo vetëm në përcimin e informacionit të marrë nga grupet dhe institucionet të cilët ata përfaqësojnë ose nga partnerët e tyre lokalë, por edhe për të filluar lobimin për aplikimin e teknikës më të përshtatshme për secilën nga Bashkitë.

“Përmirësimi i Qëndrueshmërisë së OJF-ve”, mbështetur nga Qendra ndërkombëtare Olof Palme

Në Janar 2007, Partnerët-Shqipëri filloi zbatimin e një programi të ri trainimi dhe asistence teknike të titulluar “Përmirësimi i Qëndrueshmërisë së OJF-ve”.

Përfitues të këtij programi janë dhjetë organizata: *Unë, Gruaja!* dhe *Gruaja Intelektuale* në Pogradec, *Forumi i Gruas* dhe *Shëndeti Publik* në Elbasan, *Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit* dhe *Every Child* në Tiranë, *The Door* dhe *Shpresë për të Ardhmen* në Shkodër, *Rinia* në Sipërmarrjen e Lirë në Kukës, *Shoqata e Grave me Probleme Sociale* në Durrës.



Trainimi në Planifikim Strategjik, Tiranë

Nëpërmjet këtij projekti, Partnerët Shqipëri ka për qëllim të risë qëndrueshmërinë organizative të këtyre OJF-ve duke dizenuar dhe zbatuar plane strategjike afatgjata, duke forcuar kapacitetet e tyre në manaxhim financiar dhe sistemin e buxhetimit si një mënyrë për të rritur transparencën.

Programi mbështetet nga Qendra ndërkombëtare Olof Palme. Zbatimi i tij po realizohet nëpërmjet disa fazave, për një periudhë kohore një vjeçare.

Faza e parë konsistoi në përzgjedhjen e organizatave përfituese; faza e dytë vijoi me rritjen e njohurive mbi procesin e planifikimit strategjik me anë të një programi trainimi tre-ditor ku morrën pjesë 20 përfaqësues nga dhjetë organizata; faza e tretë është edhe faza më e gjatë dhe më komplekse e këtij programi e cila konsiston në asistencë teknike për hartimin e planit strategjik dhe ndërtimin e sistemeve të manaxhimit financiar



Seminari me shoqatën The Door në Shkodër

sipas standarteve bashkëkohore. Procesi i planifikimit strategjik ka konsistuar në realizimin e Fokus Grupeve dhe Intervistave, si dhe organizimin e Seminareve (Retreat) ku pjesëmarrësit mblodhën informacion të bollshëm, opinione dhe ide rreth të ardhmes së organizatave të tyre.

Seminaret u vlerësuan shumë nga pjesëmarrësit të cilët u shprehën se ky process ishte mjaft i vlefshëm për ta dhe një mundësi e mirë për të hedhur në letër atë çfarë ata diskutojnë vazhdimisht në lidhje me të ardhmen e organizatës.

Programi i Trainimeve dhe Asistencës Teknike me PSHM

Sic e kemi njoftuar edhe në edicionet e mëparshme, Partnerët-Shqipëri ka krijuar një bashkëpunim të frytshëm me PSHM (Partneri Shqiptar në Mikrokredit) për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të këtij institucioni.

PSHM është një institucion financiar me objektiva ambicioze të cilat mendon t'i arrijë nëpërmjet rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe rritjes së njohurive të personelit në tema të tilla si “Manaxhimi i Ndryshimit”, “Komunikimi dhe Manaxhimi i Konfliktit” dhe “Kujdesi Efektiv ndaj Klientit dhe Shitjet Efektive”. Pikërisht në këto tema është orientuar edhe trainimi dhe asistencë e ofruar nga Partnerët-Shqipëri deri në këtë periudhë.

Pjesëmarrësit në programet e trainimit ishin Manaxherë Degësh, Zyrash, Oficerë Kredie etj të PSHM. Ata i kanë mirëpritur këto trainime e kanë qenë mjaft aktivë, duke sjellë eksperiencat e tyre dhe opinione për mënyrën se si mund të aplikojnë këto njohuri në praktikë. Skuadra e trainerëve të Partnerëve-Shqipëri kanë drejtuar me një profesionalizëm e dedikim të lartë këto trainime.

Mbështetje për Qëndrueshmëri ofruar Qendrave Ndërfetare

Partnerët – Shqipëri, konsultoi dhe mbështeti tre Qëndrat Ndërfetare të ngritura nga World Learning në Shkodër, Bathore dhe Elbasan. Procesi konsistoi në rishikimin dhe përmirësimin e projekteve aktuale të qëndrave, ndarjen e eksperiencave për zbatimin e projekteve lokale, përcaktimin e sfidave për situatën reale të qëndrave dhe hartimin e planeve të qëndrueshmërisë për cdo qendër. PSH lehtësoi takime direkte midis përfaqësuesve të qëndrave dhe donatorëve të ndryshëm si Banka Botërore, Ambasada Angleze, Ambasada Norvegjeze, SOROS, Qendra Rajonale e Mjedisit dhe me disa fondacione të tjera ndërfetare.

Trainim në Antikorrupsion për të rinjtë shqiptarë

Kontraktuar nga Banka Botërore në Tiranë, Partnerët-Shqipëri realizuan një program trainimi në “Roli i Shoqërisë Civile në Iniciativat Kundër Korrupsionit”. Pjesëmarrësit ishin përfaqësues të organizatave rinore dhe trupave studentore, anëtarë të grupimit “Zëri i rinisë në Shqipëri”, të përzgjedhur nga Banka Botërore si skuadër konsultimi për politikën rinore që ky institucion do të zbatojë. Në periudhën në vazhdim, do të ofrohen për këtë grup edhe dy programe të tjera trainimi në “Lidership” dhe “Monitorim e Vlerësim”.

Programme të tjera

Programi i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë

Përgjatë muajve Shkurt dhe Mars, Agjencia e Prokurimeve Publike e mbështetur nga Programi i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, organizoi një seri seminaresh për prezantimin e ligjit të ri për prokurimet publike. Partnerët-Shqipëri, në rolin e saj si partnere në zbatim e këtij projekti, ndërmori logjistikën për organizimin e këtyre seminareve dhe përgatiti e shpërndau informacionin e nevojshëm tek grupet e interesit: përfaqësues të kompanive të ndërtimit dhe shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, anëtarë të Dhomës Amerikane të Tregtisë, anëtarë të Dhomës Shqiptare të Tregëtisë dhe Industrisë si dhe anëtare të Shoqatës së grave profesioniste dhe afariste.

Rreth 100 biznesmenë, përfaqësues ligjorë dhe manaxherë kompanish morrën pjesë në këto seminare informuese. Në fund të seminareve, Partnerët-Shqipëri përgatiti një përmbledhje me opinione dhe rekomandime të shprehura nga pjesëmarrësit.

Gjatë kësaj periudhe, Partnerët-Shqipëri hartoi Strategjinë e Komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm për Agjensinë e Prokurimeve Publike në Shqipëri (APP). Qëllimi i hartimit të këtij plani komunikimi është rritja e efektivitetit dhe transparencës së APP-s nëpërmjet



Seminar i APP për prezantimin e Ligjit të ri për Prokurimet Publike

komunikimit në mënyrë efektive me audiencën e brendshme dhe të jashtme. Plani i veprimit për hartimin e këtij dokumenti kaloi në disa etapa: vlerësimi i kapaciteteve të APP-s për

të komunikuar në mënyrë efektive me audiencën; zhvillimi i një plani komunikimi të brendshëm dhe të jashtëm; identifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e këtij plani, hartimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë së komunikimit.

Kodi i Etikës për Sektorin Jo Fitimprurës në Shqipëri

Partnerët-Shqipëri ka vijuar punën në lidhje me iniciativën për hartimin e një Kodi Etike për sektorin jo-fitimprurës në Shqipëri. Gjatë vitit 2006, më shumë se 120 OJF, përfaqësues të sektorit në rrethe të ndryshme të vendit, u njohën me iniciativën për hartimin e një Kodi Etike dhe rëndësinë e tij për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit. Përfaqësuesit e OJF-ve të pranishme në këto takime e mirëpritën këtë iniciativë, e vlerësuan si shumë të rëndësishme për kontekstin e zhvillimit të vendit tonë e vecanërisht të sektorit. Propozimet e pjesëmarrësve ishin për të vazhduar procesin me hapa shumë konkrete dhe për ta finalizuar atë brenda vitit 2007.

Në këtë kuadër, më 10 Maj 2007, P - Sh organizoi një seminar në të cilin u ftuan të merrnin pjesë përfaqësues të sektorit nga i gjithë vendi. Pjesëmarrësit në takim përfaqësonin 25 organizata lokale nga Tirana, Durrësi, Pogradeci, Elbasani dhe Gjirokastra. OJF-të pjesëmarrëse treguan edhe njëherë vullnetin e mirë për të kontribuar në hartimin e Kodit nëpërmjet sygjërimeve të tyre dhe e vlerësuan atë si një mekanizëm shumë të rëndësishëm që do t'i shërbejë në të ardhmen sektorit, forcimit të tij, ngritjes së standarteve dhe një marrëdhënieje më të mirë e më transparente ndërmjet vetë organizatave si dhe ndërmjet tyre e institucioneve shtetërore,

transparenca financiare; parandalim të Konfliktit të Interesave në nivel bordi e stafi në organizatë; mosdiskriminim; pjesëmarrje dhe partneritet (konsultim me grupet e interesit, aktorët, krijimi dhe promovimi i partneriteteve); rrjetëzimet, koordinimi, bashkepunimi dhe komunikimi - etika e Punës brenda Kodit; përfaqësimi në nivel kombëtar, rajonal e ndërkombëtar; konfidencialiteti dhe ruajtja e anonimatit në raste të veçanta (organizata që punojnë me grupe të vecanta e kanë të domosdoshme, por dhe të tjerë); misioni dhe vizioni, organizimi i programeve në përputhje me to etj.



Tryeza e Rrumbullakët për Kodin e Etikës për OJF-të, organizuar në Tiranë

Gjatë këtyre muajve, puna e P-Sh është fokusuar në studimin e modeleve ndërkombëtare të Kodit nga vende të ndryshme të Botës dhe analizimin e funksionimit të tij.

përputhshmëri me ligjet vendase dhe konventat ndërkombëtare; qeverisje e mirë; përgjegjshmëri të të gjithë aktorëve; transparencë të aktiviteteve të OJF-ve;

komunitetit të donatorëve dhe publikut në përgjithësi.

Në takim, përfaqësuesit e OJF-ve diskutuan mbi parimet kryesore që duhet të përmbajë Kodi mes të cilave si shumë të rëndësishme për t'u pasqyruar u theksuan:

Në vijim të punës, Partnerët - Shqipëri si lehtësuese e këtij procesi, do të presë deri në fund të muajit Maj komente dhe sygjërime në lidhje me parimet bazë të trajtuara në Kod, si nga pjesëmarrësit në takim, dhe nga ata të cilët për arsye të ndryshme nuk mundën të marrin pjesë, por që kanë treguar interes e janë vënë në dijeni për zhvillimin e takimit dhe përmbajtjen e tij. Pas kësaj, propozimet do të shqyrtohen nga një grup i ngushtë teknik, i përbërë nga ekspertë të cilët do të hartojnë një draft të parë të Kodit i cili më pas do të kalojë sërish për komentet e OJF-ve përpara finalizimit të tij.

Vlerësimi i Kapaciteteve Advokuese të Sektorit të OJF-ve Shqiptare - Raport Kombëtar

Partnerët - Shqipëri ka botuar raportin e Vlerësimit të Kapaciteteve Advokuese të Sektorit të OJF-ve Shqiptare, studim i kryer gjatë periudhës Nëntor - Dhjetor 2004. Qëllimi i këtij vlerësimi ishte analiza e kapaciteteve institucionale të OJF-ve që punojnë në fushën e advokatisë, e parë kjo në aspektin e mobilizimit të anëtarëve dhe mbështetësve si pjesë e proceseve vendimmarrëse ekonomike dhe politike; kapacitetit organizativ dhe financiar për të mbështetur çështje me interes të përbashkët në mjedisin social, politik dhe ekonomik ku ato veprojnë; qëndrimit të institucioneve qeveritare dhe mbështetjes së tyre ndaj sektorit të OJF-ve si dhe aksesit e marrëdhënieve të OJF-ve me median.

Konkluzionet e vlerësimit, si dhe rekomandimet përkatëse i shërbyen P-Sh si pika referimi për hartimin e programit të trainimit dhe të asistencës për sektorin e OJF-ve lokale shqiptare në kuadër të programit DQSH, si dhe për rifreskimin e informacionit të Adresarit të OJF-ve Shqiptare.

Kontaktimi me zyrën e Partnerëve - Shqipëri për të tërhequr kopje këtij studimi i cili është i vlefshëm në shqip dhe anglisht.

Konferenca Kombëtare "Të drejtat e njeriut, pjesëmarrja në qeverisjen lokale dhe zhvillimin rajonal ekonomik"

Në datë 25 Maj 2007, KRIIK-ALBANIA organizoi Konferencën Kombëtare "Te drejtat e njeriut, pjesëmarrja në qeverisjen lokale dhe zhvillimin rajonal ekonomik". Partnerët-Shqipëri u përfaqësuan në këtë konferencë nga Jonida Alite, Trainere /Manaxhere Programi pranë PSh-së e cila mbajti një kumtesë mbi "Rritjen e rolit dhe përfshirjes së të rinjve në qeverisjen vendore dhe qendrore". Në këtë konferencë morrën pjesë ekspertë dhe drejtues të drejtorive përkatëse në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe vendase që punojnë dhe përfaqësojnë të rinjtë nga të gjitha prefekturat e Shqipërisë, përfaqësues të forumeve politike, sociologë, analistë dhe përfaqësues të medias.

Aktivitetet e Ardhshme

■ Gjatë periudhës në vazhdim Partnerët-Shqipëri do të vazhdojë të zbatojë projektet në fushën e demokracisë, qëndrueshmërisë së shoqërisë civile, biznesit, standarteve etike etj. Kështu, gjatë muajve në vazhdim do realizohen pesë programe trainimi në "Qeverisjen me Pjesëmarrje" dhe tetë programe trainimi në "Teknikat e Qeverisjes me Pjesëmarrje".

■ Nën projektin "Përmirësimi i Qëndrueshmërisë së OJF-ve" mbështetur nga Olof Palme do të vazhdojë asistencë teknike në shkruarjen e planit strategjik dhe në ngritjen e sistemeve të manaxhimit financiar.

■ Në muajin Qershor planifikohet të diskutohet drafti i parë i Kodit të Etikës së OJF-ve për gatitur nga grupi i ekspertëve.

■ Në kuadrin e bashkëpunimit me PSHM-n do të vazhdojë gjatë muajit Qershor seria e trainimeve në temën "Performance Coaching".

■ Në kuadrin e programit rajonal për ngritjen e kapaciteteve të lidhshmeve lokale të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore gjatë periudhës në vazhdim do ofrohet trainim dhe asistencë teknike për shkrim dhe manaxhim projektesh për stafin e Bashkisë së Sarandës.

Partnerët - Shqipëri është një organizatë jo-qeveritare shqiptare me mision zhvillimin e shoqërisë civile shqiptare dhe të një kulture ndryshimi dhe manaxhimi konfliktesh. Partnerët-Shqipëria është anëtare e Rrjetit Ndërkombëtar të Partnerëve për Ndryshim Demokratik (Partnerët), një rrjet Qendrash në 15 vende të botës, të cilat japin trajnime për zgjidhje konflikti si dhe shërbime për shoqërinë, OJF-të, qeverinë qendrore dhe vendore, dhe sektorin privat në vendet e tyre dhe në vende të tjera në botë. Adresa e Internetit e PDCI është: partners@partnersglobal.org

**PARTNERET- SHQIPERI
QENDRA PER NDRYSHIM DHE MANAXHIM
KONFLIKTI
Adresa: Rruga Pjetër Bogdani, nr.41,
Kutia Postare 2418/1,
Posta Qendrore, Tiranë
Tel: +355 4 254881/3 Fax: 273351
Email: partners@partnersalbania.org
Http: [//www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)**